


LegalNews

April 2023
Prill 2023

SPECIAL



Deloitte.

Ligji "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" (në vijim "Ligji"), i cili përcakton ndër të tjera nxitjen e përdorimit të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, rregullat për mbështetjen e energjisë së prodhuar nga këto burime, rregullat për Garancitë e Origjinës si dhe rregullat për integrimin e vetëprodhuesve.

Ligji synon të nxisë rritjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme, të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse fosile, emetimin e gazeve me efekt serrë dhe të mbrojë mjedisin, të rrisë diversifikimin e burimeve të energjisë dhe të nxisë zhvillimin e zonave rurale dhe të izoluara duke përmirësuar furnizimin e tyre me energji.

Ky Ligj është afruar pjesërisht me Direktivën 2018/2001/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", datë 21.12.2018

Ligji shfuqizon ligjin nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

I. Përcaktimi i Objektivave Kombëtare dhe marrëdhënia me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë

- Objektivat kombëtare për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë vendosen në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës ("PKEK").

Law "On the promotion of the use of energy from renewable sources"

The Parliament of the Republic of Albania has approved Law no. 24/2023, "On the promotion of the use of energy from renewable sources" (hereinafter the "Law"), which determines, among other things, the promotion of the use of energy produced from renewable sources, the rules for supporting the energy produced from these sources, the rules for Guarantees of Origin, the rules for the integration of self-producers.

The Law aims to increase the use of energy from renewable sources, to reduce the import of fossil fuels, the emission of greenhouse gases and protect the environment, to increase the diversification of energy sources and to promote the development of rural and isolated areas by improving their supply with energy.

The Law is partially aligned with Directive 2018/2001/EC of the European Parliament and of the Council "On the promotion of the use of energy from renewable sources", dated 21.12.2018.

The Law repeals law no. 7/2017 "On the promotion of the use of energy from renewable sources".

I. Determination of National Objectives and the relation with the Energy Community Secretariat

- The national objectives for the share of energy from renewable sources in the gross final consumption of energy are set in the National Energy and Climate Plan ("NECP").

- Ministria përgjegjëse do të raportojë tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbi zbatimin e PKEK me anë të një Raporti Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Progresit.
- Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë në vitin 2030 do të jetë 54.4%.
- The responsible Ministry shall report to the Energy Community Secretariat on the implementation of the NECP through a National Integrated Energy and Progress Report.
- The share of energy from renewable sources in gross final energy consumption in 2030 is projected to be 54.4%.

II. Prodhuesit me Përparësi dhe Skemat Mbështetëse

- Prodhues me Përparësi konsiderohet çdo prodhues i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë që përfiton nga skemat mbështetëse:
 - (i) *Marrëveshje për Blerje të Energjisë (MBE)* - formë skemë mbështetje ku një blerës i caktuar garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks;
 - (ii) *Kontratës për diferencë (KD)* - formë skemë mbështetje, ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) i paguan Prodhuesit me Përparësi një diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur ky është më i ulët, dhe Prodhuesi me Përparësi i paguan OER diferencën kur ky çmim është më i lartë;
 - (iii) *Kontratë Prim* - formë skemë mbështetje ku paguhet një prim fiks ose një prim rrëshqitës nga OER për Prodhuesit me Përparësi mbi çmimin e tregut.

II. Priority Producers and Support Schemes

- Priority Producer is considered any producer of electricity from renewable energy sources that benefits from one of the support schemes:
 - (i) *Power Purchase Agreement (PPA)* - is a type of support scheme where a designated recipient guarantees the mandatory purchase of electricity generated by producers for a fixed price.
 - (ii) *Contract for difference (CoD)* - is a type of support scheme, where the Renewable Energy Operator (REO) pays to the Priority Producer the difference between the guaranteed price and the reference price when it is lower, and the Priority Producer pays the difference to the REO when this price is higher;
 - (iii) *Premium Contract* - is a type of support scheme where a fixed or a sliding premium (is paid by the REO to Priority Producers over the market price.

- Mbështetja për Prodhuesit me Përparësi jepet përmes një procesi konkurrues, i cili me vendim të Ministrisë mund të jetë neutral ndaj teknologjisë ose i kufizuar në një teknologji specifike.
- Deri në krijimin e një tregu likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë, mbështetja mund të jepet në formën e një MBE e cila duhet të nënshtrohet konvertimit në një KD pas krijimit të këtij tregu.
- Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përkatës miraton masat mbështetëse, dhe rregullat dhe procedurat e procesit konkurrues.
- Support for Priority Producers is provided through a competitive process, which at the decision of the Ministry may be technology neutral or limited to a specific technology.
- Support may be provided in the form of a PPA that should be subject to conversion into a CoD after the establishment of an advanced day-ahead electricity market.
- The Council of Ministers, with the proposal of the relevant Minister, approves the supporting measures, and the rules and procedures of the competitive process.

III. Projektet Demonstruese

- Projektet demonstruese demonstrojnë një teknologji si të parën e këtij lloji në Bashkimin Evropian dhe Komunitetin e Energjisë dhe që përfaqëson një inovacion të rëndësishëm që është përtej teknologjisë modern.
- Mbështetja për projektet demonstruese përcaktohen nga Këshilli i Ministrave dhe nuk kalojnë në një proces konkurrues.
- Projektet demonstruese me kapacitet më të vogël se 10.8 kW u nënshtrohen procedurave lehtësuese të lidhjes në rrjet përmes njoftimit ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

IV. Vetëprodhuesit e Energjisë së Rinovueshme

- Vetëprodhuesit e energjisë rinovueshme do të kenë një kapacitet maksimal prej **500 kW** dhe do të kenë të drejtë të gjenerojnë, konsumojnë,

III. Demonstration Projects

- Demonstration projects display technology as the first of its type in the European Union and the Energy Community and that represents a significant innovation that is beyond modern technology.
- Support for demonstration projects are defined by the Council of Minister, and do not participate in a competitive process.
- Demonstration projects with a capacity of less than 10,8 kW are subject to facilitated grid connection procedures through a notification to the Distribution System Operator.

IV. Self-producers of Renewable Energy

- Self-producers of renewable energy will have a maximum capacity of **500 kW** and will have the right to generate, consume, store and sell excess renewable

ruajnë dhe shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, duke përfshirë përmes marrëveshjeve dypalëshe, furnizuesve të energjisë elektrike dhe marrëveshjeve të tregtisë me homologët, pa u përballur me ngarkesa diskriminuese ose jo proporcionale.

- Të drejtat dhe përgjegjësitë e vetëprodhuesve të energjisë së rinovueshme përcaktohen në një vendim të propozuar nga Ministria dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- Vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë blloqet me shumë apartamente, kanë të drejtë të angazhohen bashkërisht si vetëprodhues të energjisë së rinovueshme.
- Çmimi për energjinë elektrike të gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme përcaktohet nga ERE duke siguruar një kompensim të drejtë që shmang diskriminimin midis tyre dhe konsumatërore të tjerë.
- Deri më **1 Janar 2024**, vetëprodhuesit mund të instalojnë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme për të mbuluar një pjesë të energjisë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

V. Masat Mbështetëse për Depozitim

- Ministri mund të miratojë masa të kufizuara në formën e granteve, kredive për investim, primit ose mbështetje të tjera operative, për

electricity production, including through bilateral agreements, electricity suppliers and peer-to-peer trade agreements, without facing discriminatory or disproportionate burdens.

- The rights and obligations of self-producers of renewable energy shall be defined in a decision proposed by the Ministry and approved by the Council of Ministers.
- Self-producers of renewable energy located in the same building, including multi-apartment blocks, have the right to engage jointly as self-producers of renewable energy.
- The price for electricity generated by self-producers of renewable energy is determined by ERE, ensuring fair compensation that avoids discrimination between them and other consumers.
- Until **January 1st, 2024**, self-producers are allowed to install a total capacity of up to 500 kW for the production of electricity from renewable sources to cover a portion of their own energy needs and inject excess energy generated into the distribution grid.

V. Storage Support Measures

- The Minister may approve limited measures in the form of grants, investment credits, premium or other operating support,

të mbështetur një teknologjisë specifike të ruajtjes së livruar nga energjia e rinovueshme e energjisë elektrike, për të arritur reduktimin e emetimeve të CO2 ose sigurinë e furnizimit ose optimizimin e përdorimit të prodhimit të energjisë së rinovueshme. Këto masa mbështetëse jepen nëpërmjet një procesi konkurrues të përcaktuar me vendim të Ministrit.

- Ministri përkatës, pas mendimit paraprak nga ERE mund të marrë një vendim për formën dhe kushtet e skemës së mbështetjes për kapacitetet e depozitimit, kur këto kapacitete nuk përmbushin objektivat e përcaktuara.

VI. Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme

- Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme është një entitet juridik, me pjesëmarrje të hapur dhe vullnetare, autonom, me anëtar persona fizik ose autoritete lokale, qëllim kryesor i të cilit është të sigurojë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale të komunitetit për aksionaret ose anëtarët e tij ose për zonat lokale ku operon, në vend të fitimeve financiare.
- Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme ka të drejtë të prodhojë, konsumojë, ruajë, ndajë, shesë energji të rinovueshme dhe të ofrojë agregim.
- Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme ka të drejtë të mbështetet si prodhues me përparësi, si dhe mund të trajtohet me vendim të Këshillit të Ministrave si projekt demonstrues.

to support a specific storage technology delivered by renewable electricity, to achieve reductions in CO2 emissions or security of supply or optimization of the use of renewable energy production. These support measures are provided through a competitive process determined by decision of the Minister.

- The relevant Minister, after the preliminary opinion from ERE, can take a decision on the form and the conditions of the support scheme for storage capacities, when these capacities do not fulfill the defined objectives.

VI. Renewable Energy Community

- The Renewable Energy Community is a legal entity, with open and voluntary participation, autonomous, with natural persons as members or local authorities, whose main purpose is to provide environmental, economic or social benefits to the community for its shareholders or its members or to the local areas where it operates, rather than financial profits.
- The Renewable Energy Community has the right to produce, consume, store, share, sell renewable energy and provide aggregation.
- The Renewable Energy Community has the right to be supported as a priority producer, and can, through a decision of the Council of Ministers be treated as a demonstration project.

VII. Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER)

- OER është pala kontraktuese e Prodhuesve me Përparësi.
- OER do të jetë blerësi i të gjithë Prodhuesve me Përparësi që janë me mbështetje në formën e një MBE dhe do ta shpërndajë këtë energji direkt në tregun e organizuar.
- Kostot e OER do të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme e cila paguhet nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike.
- OER do të themelohet dhe regjistrohet nga Ministra brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, dhe deri në krijimin e tij detyrat do të merren nga furnizuesi në tregun e lirë me mbikëqyrjen e ERE.

VII. Renewable Energy Operator (REO)

- The REO is the contracting party of Priority Producers.
- OER will be the buyer of all Priority Producers that are supported in the form of an PPA and will distribute this power directly to the organized market.
- The costs of OER will be covered through the renewable energy obligation which is paid by the final consumers of electricity.
- The OER will be established and registered by the Minister within 6 months from the entry into force of this Law, and until its establishment, the competences shall be performed by the supplier in the free market under the supervision of the ERE.

VIII. Garancitë e Origjinës

- Garancia e Origjinës është një dokument elektronik, i cili i provon konsumatorit përfundimtar se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.
- Garancia e Origjinës do të lëshohet nga ERE me kërkesë të prodhuesit të energjisë, dhe është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
- ERE do të veprojë si organi kombëtar lëshues i Garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe do të vendosë një sistem për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe revokimin/anulimin

VIII. Guarantees of Origin

- A Guarantee of Origin is an electronic document, that proves to the final consumer that part or all of the given amount of energy has been produced from renewable sources.
- The Guarantee of Origin will be issued by ERE upon request of the producer of energy from renewable sources and is valid for one year starting from the last day of the production period for which it was issued.
- ERE will act as the national body issuing Guarantees of Origin in the Republic of Albania and will establish a system for issuing, transferring, redeeming and revoking/cancelling Guarantees of

e Garancive të Origjinës në lidhje me energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë.

- Garancitë e Origjinës janë të transferueshme.

Origin related to energy produced from renewable energy sources.

- The Guarantees of Origin are transferable.

IX. Burimet e Rinovueshme në Sektorin e Transportit, Ngrohjes dhe Ftohjes dhe Prodhimit të Ujit të Nxehtë

- Masat nxitëse dhe promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në transport përcaktohen me ligj të veçantë.
- Këshilli i Ministrave përcakton treguesit minimalë për prodhimin e ujit të ngrohtë urban për përdorim higjienik dhe për proceset teknologjike, i përfshirë prej sistemeve të paneleve diellore.
- Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton një vendim për të mbështetur arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes.

Ky Ligj është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 64, datë 14.04.2023 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas këtij publikimi.

IX. Renewable Resources in the Transport Sector, Heating and Cooling and Hot Water Production

- Incentives and promotional measures for the use of renewable energy sources in the transport sector shall be determined by a special law.
- The Council of Ministers determines the minimum indicators for the production of urban hot water for hygienic use and for technological processes, obtained from solar panel systems.
- The Council of Ministers, with the proposal of the Minister, adopts a decision to support the achievement of the national objective for renewable energy sources in the heating and cooling sector.

The Law is published in the Official Journal No. 64, dated 14.04.2023 and enters into force 15 days after the publication.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing’s affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte’s approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.